

20131643952

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E
LIGJIT PËR MBROJTJE TË TRASHËGIMISË KULTURORE

Neni 1

Në Ligjin për mbrojtje të trashëgimisë kulturore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 20/2004, 115/2007, 18/11, 148/11 dhe 23/13), në nenin 88 në paragrafin (4) fjalët: "Ministria e Kulturës" zëvendësohen me fjalën "Drejtoria", pas fjalës "provim" vihet pikë, ndërsa fjalët: "para komisionit që e formon Ministria e Kulturës" shlyhen.

Paragrafët (5) dhe (10) shlyhen.

Paragrafët (6), (7), (8) dhe (9) bëhen paragrafë (5), (6), (7) dhe (8).

Neni 2

Pas nenit 88 shtohen tituj të rinj dhe 24 nene të reja, si vijojnë 88-a, 88-b, 88-v, 88-g, 88-d, 88-gj, 88-e, 88-zh, 88-z, 88-x, 88-i, 88-j, 88-k, 88-ll, 88-l, 88-m, 88-n, 88-nj, 88-o, 88-p, 88-r, 88-s, 88-t dhe 88-q, si vijojnë:

"Kushte për dhënie të provimit për marrje të licencës për konservator

Neni 88-a

(1) Provimi për marrje të licencës për konservator (në tekstin e mëtejme: provimi) jepet për kontrollit të njohurisë së nevojshme profesionale nga sfera e mbrojtjes së drejtpërdrejtë të trashëgimisë kulturore të patundshme dhe të tundshme.

(2) Provimin mund ta japë personi i cili i përmbush kushtet si vijojnë:

- të ketë arsim të lartë (diplomë për arsim të lartë të mbaruar katërvjeçar ose diplomë me 300 kredi sipas sistemit evropian për transfer të kredive (SETK) nga sfera e arkitekturës, ndërtimtarisë, artit figurativ dhe të aplikuar, arkeologjisë, historisë së artit, teknologjisë, kimisë, fizikës, biologjisë, biokimisë ose specialitet tjetër përkatës për mbrojtje të drejtpërdrejtë të trashëgimisë kulturore të patundshme apo të tundshme) dhe

- të ketë së paku dy vjet përvojë pune pas diplomimit, në sferën përkatëse të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore të patundshme dhe të tundshme.

Mënyra e realizimit të provimit

Neni 88-b

(1) Provimi përbëhet prej tri pjesëve dhe atë:

- pjesa e parë (pjesa teorike), me të cilën kontrollohet njohuria teorike e kandidateve,
- pjesa e dytë (shembulli praktik), me të cilin kontrollohet aftësia praktike e kandidatëve dhe
- pjesa e tretë (mbrojtja e temës profesionale të punuar me shkrim nga sfera e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore të patundshme ose të tundshme).

(2) Pjesa e parë e provimit jepet me shkrim, me përgjigje të numrin të caktuar të pyetjeve në formë të zgjidhjes së testit elektronik në kompjuter.

(3) Pyetjet nga pjesa e parë e provimit janë nga sfera e rregullave vendase dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

(4) Pjesa e dytë e provimit përbëhet nga:

- shembulli praktik me përgjigje të pyetjeve nga sfera përkatëse për punë të mbrojtjes së drejtpërdrejtë të trashëgimisë kulturore të patundshme dhe të tundshme që duhet kandidati t'u përgjigjet në formë të testit elektronik në kompjuter.

(5) Pjesa e tretë e provimit jepet si mbrojtje e temës profesionale të punuar me shkrim, para komisionit nga neni 88-g paragrafi (2) të këtij ligji. Tema profesionale mund të jetë për tërësi tematike të përmbajtura në programin nga neni 88-v paragrafi (1) të këtij ligji, veçanërisht në aspekt të historisë së metodave konservative, mënyrës dhe kushteve të ekspozimit, vendosjes, ruajtjes, manipulimit dhe shfrytëzimit (për trashëgimi të tundshme kulturore), përkatësisht organizim të kantierit (për trashëgimi të patundshme kulturore), masave të planifikuara dhe metodave të konservimit të trashëgimisë së patundshme dhe të tundshme kulturore, sistemit të dokumentimit dhe çështje tjera lidhur me metodologjinë e propozuar të mbrojtjes së drejtpërdrejtë.

(6) Temën profesionale nga paragrafi (5) i këtij neni kandidatit ia cakton komisioni nga neni 88-g paragrafi (2) të këtij ligji.

Neni 88-v

(1) Provimi jepet sipas programit në të cilin përmbahet materiali, rregullat, literatura dhe tërësitë tematike.

(2) Programin nga paragrafi (1) të këtij neni e miraton ministri i Kulturës.

Neni 88-g

(1) Bazat e pyetjeve për pjesën e parë të provimit, bazat e shembujve praktikë për pjesën e dytë të provimit dhe temat profesionale për mbrojtjen e pjesës së tretë të provimit nga neni 88-ll paragrafi (6) të këtij ligji i përpilojnë punëtorë shkencorë dhe profesionalë nga sfera e konservimit dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore të patundshme dhe të tundshme, të caktuar nga drejtori i Drejtorisë.

(2) Pyetjet nga pjesa e parë e provimit, pyetjet dhe shembujt praktikë nga pjesa e dytë e provimit dhe temat profesionale për mbrojtjen e pjesës së tretë të provimit i verifikon komisioni i caktuar nga drejtori i Drejtorisë, i përbërë prej dy përfaqësuesve nga Drejtoria dhe pesë përfaqësuesve nga radhët e punëtorëve shkencorë dhe profesionalë nga sfera e konservimit dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore të patundshme dhe të tundshme.

(3) Komisioni nga paragrafi (2) i këtij neni e vlerëson edhe mbrojtjen e temës profesionale të punuar me shkrim.

(4) Komisioni nga paragrafi (2) të këtij neni, së paku një herë në vit kryen revizion dhe azhurnim të bazave të pyetjeve, bazave të shembujve praktikë dhe bazave të temave profesionale nga neni 88-ll paragrafi (6) të këtij ligji.

(5) Gjatë revizionit komisioni veçanërisht i ka parasysh ndryshimet në rregullat, praktikën dhe standardet në të cilat bazohet pyetja, përkatësisht shembulli praktik, përkatësisht temat profesionale për mbrojtje, numrin e kandidatëve që i janë përgjigjur, suksesin në përgjigjen e tyre, si dhe kriteret tjera që mund të ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së bazave nga neni 88-ll paragrafi (6) të këtij ligji.

(6) Në bazë të revizionit të kryer dhe azhurnimit të bazave të pyetjeve, bazave të shembujve praktikë dhe temave profesionale për mbrojtje, komisioni vendos nëse pyetjet, shembujt praktikë dhe temat profesionale për mbrojtje do të ndryshohen ose mënjahen plotësisht nga bazat e nenit 88-ll paragrafi (6) të këtij ligji.

(7) Punëtorët shkencorë dhe profesionalë nga paragrafi (1) të këtij neni dhe anëtarët e komisionit nga paragrafi (2) të këtij neni kanë të drejtë të kompensimit në para që e përcakton drejtori i Drejtorisë.

(8) Shuma e kompensimit në para nga paragrafi (7) i këtij neni përcaktohet në bazë të numrit të pyetjeve të përpiluara, shembujve praktikë dhe temave profesionale për mbrojtje, si dhe ndërlikueshmërisë së materies.

(9) Kompensimi vjetor në para nga paragrafi (7) i këtij neni, nuk e tejkalon nivelin e tri rrogave mesatare të paguara në Republikën e Maqedonisë, në vitin paraprak, të publikuara nga Enti Shtetëror i Statistikës i Republikës së Maqedonisë.

Neni 88-d

Punët profesionale dhe administrative për nevojat e realizimit të provimit i kryen Drejtoria, ndërsa provimin teknikisht e realizon personi juridik i regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë, i zgjedhur nga Drejtoria.

Neni 88-gj

Provimi realizohet katër herë në vit edhe atë në shkurt, qershor, shtator dhe dhjetor.

Neni 88-e

(1) Kërkesën për dhënie të provimit, kandidati e parashton në Drejtori.

(2) Me kërkesën për dhënie të provimit, kandidati është i detyruar të parashtrojë dëshmi për përmbushjen e kushteve për dhënie të provimit, të përcaktuara në nenin 88-a paragrafi (2) të këtij ligji.

Neni 88-zh

(1) Drejtori i Drejtorisë ose personi i autorizuar prej tij, me aktvendim përcakton nëse kandidati i përmbush kushtet për dhënie të provimit.

(2) Kundër aktvendimit me të cilin refuzohet kërkesa për dhënie të provimit, mund të ngrihet kontest administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

(3) Kandidatit të cilit i është miratuar kërkesa për dhënie të provimit, i caktohet koha dhe vendi për dhënie të provimit, ndërsa kandidati njoftohet më së voni në afat prej tetë ditësh para dhënies së provimit.

(4) Kandidatit i mundësohet të fillojë ta japë provimin në terminin e parë të ardhshëm nga dita e kërkesës së miratuar për dhënie të provimit.

(5) Kandidati është i detyruar ta paraqesë dhënien e provimit nga dita e parë deri në ditën e 15-të të muajit, që i paraprin muajit në të cilin mbahet provimi.

Neni 88-z

(1) Provimi jepet në lokal për dhënie të provimit, i pajisur veçanërisht për dhënie të provimit me pajisje materiale-teknike dhe informatike, internet lidhje dhe pajisje për incizim të dhënies së provimit.

(2) Dhënia e provimit incizohet dhe drejtpërdrejt emitohet në ueb faqen e Drejtorisë, e nëse për shkaqe teknike incizimi ndërpritet, incizimi i provimit të plotë vendoset në ueb faqen e Drejtorisë.

(3) Kushtet hapësinore për pajisje materiale-teknike dhe informatike të lokaleve për dhënie të provimit, i përcakton ministri i Kulturës.

(4) Në lokalin për dhënie të provimit, gjatë kohës së dhënies së provimit është i pranishëm përfaqësuesi i Drejtorisë dhe i Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës (informatikan). Përfaqësuesi nga Drejtoria mban procesverbal për dhënien e provimit.

Neni 88-x

(1) Para fillimit të dhënies së provimit, përfaqësuesi nga Drejtoria e përcakton identitetin e kandidatit me shikim të letërnjoftimit.

(2) Kandidatit gjatë dhënies së pjesës së parë të provimit nuk i lejohet shfrytëzimi i literaturës profesionale, telefonit mobil, aparateve kompjuterike portative dhe mjeteve tjera teknike dhe informatike dhe ngjashëm.

(3) Kandidatit gjatë dhënies së pjesës së parë dhe të dytë të provimit nuk i lejohet të kontaktojë me kandidatë ose persona tjerë përveç me informatikanin nga neni 88-z paragrafi (4) të këtij ligji, në rast se ka problem teknik me kompjuterin.

(4) Nëse problemet teknike me kompjuterin mënjanoen për pesë minuta provimi vazhdon, e nëse nuk mënjanoen në këtë afat provimi vetëm për atë kandidat ndërpritet dhe do të mbahet në afat prej më së shumti tri ditësh nga dita e ndërprerjes së provimit.

(5) Nëse ka probleme me më shumë se tre kompjuterë të shfrytëzuar për dhënie të provimit dhe ato nuk mënjanoen në afat prej pesë minutash, provimi ndërpritet për të gjithë kandidatët që e japin provimin dhe do të mbahet në afat prej më së shumti tri ditësh nga dita e ndërprerjes së provimit.

(6) Nëse kandidati gjatë dhënies së pjesës së parë dhe të dytë të provimit vepron në kundërshtim me paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, nuk do t'i lejohet dhënie e mëtejme e provimit në atë termin të caktuar.

(7) Në rastet nga paragrafi (6) të këtij neni, konsiderohet se kandidati nuk e ka dhënë provimin dhe kjo konstatohet në procesverbalin për dhënie të provimit.

(8) Përfaqësuesit nga neni 88-z paragrafi (4) të këtij ligji, gjatë kohës së dhënies së provimit nuk guxojnë të qëndrojnë më gjatë se pesë sekonda në afërsi të drejtpërdrejtë të kandidatit i cili e jep provimin, përveç në rast të mënjanimin të problemit teknik kur nuk guxojnë të qëndrojnë më gjatë se pesë minuta.

Neni 88-i

(1) Nëse gjatë dhënies së provimit, në periudhën ndërmjet pjesës së parë, të dytë dhe të tretë të provimit, krijohen shkaqe për të cilat kandidati nuk mund ta vazhdojë dhënien e pjesës së dytë, përkatësisht të tretë të provimit (sëmundje, pushim të lindjes dhe ngjashëm), provimi do të ndërpritet për një kohë të caktuar, që nuk mund të zgjatë më gjatë se gjashtë muaj.

(2) Aktvendim për vazhdim të provimit miraton drejtori i Drejtorisë me lutje të kandidatit. Lutja parashtrohet në afat prej tetë ditësh nga ndërprerja e shkaqeve për prolongimin e provimit, por më së voni në afat prej gjashtë muajsh.

(3) Nëse kandidati nuk paraqet lutje për vazhdim të provimit në afatin e caktuar në paragrafin (2) të këtij neni do të konsiderohet se nuk e ka dhënë provimin.

(4) Kundër aktvendimit të drejtorit të Drejtorisë nga paragrafi (2) të këtij neni kandidati mund të ngrejë kontest administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

(5) Në vazhdimin e dhënies së provimit, kandidati nuk e jep pjesën e provimit që paraprakisht tanimë e ka dhënë.

Pjesa e parë, e dytë dhe e tretë e provimit dhe sistemi elektronik

Neni 88-j

(1) Provimi fillon me dhënien e pjesës së parë (pjesës teorike), pastaj të pjesës së dytë (pjesës praktike), e pastaj të pjesës së tretë të provimit (mbrojtjes së temës profesionale të punuar me shkrim nga sfera e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore të patundshme ose të tundshme).

(2) Pjesa e dytë e provimit jepet në afat prej së paku 15 ditësh pas dhënies me sukses të pjesës së parë.

(3) Kandidati i cili e ka dhënë pjesën e parë dhe të dytë të provimit ka të drejte ta japë pjesën e tretë të provimit. Komisioni nga neni 88-g paragrafi (2) të këtij ligji kandidatit, në afat prej 5 ditësh nga dita e dhënies me sukses të pjesës së dytë të provimit, i cakton temë profesionale, që kandidati duhet ta punojë dhe ta dorëzojë në Drejtori në afat prej dy muajsh.

(4) Mbrojtja e temës profesionale mbahet para komisionit nga neni 88-g paragrafi (2) të këtij ligji, në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të saj në Drejtori.

(5) Komisioni nga neni 88-g paragrafi (2) të këtij ligji mbrojtjen e temës profesionale të kandidatit e vlerëson me vlerësim “e ka dhënë” përkatësisht “nuk e ka dhënë”.

(6) Mënyrën e ndarjes së pikave në pjesën e parë dhe të dytë të provimit i përcakton ministri i kulturës.

Neni 88-k

(1) Pjesa e parë e provimit përmban së paku 50 pyetje me pesë përgjigje të mundshme për rrethim prej të cilave njëra është e saktë, dy janë të ngjashme, njëra është e pasaktë në masë të vogël (në të humben numër i vogël pikësh) dhe njëra është e pasaktë në masë të madhe (në të humben numër i madh pikësh).

(2) Kusht për dhënien e pjesës së dytë të provimit është që kandidati ta japë pjesën e parë të provimit.

(3) Nëse kandidati nuk e jep pjesën e parë të provimit, do të konsiderohet se provimin nuk e ka dhënë.

(4) Pjesa e dytë e provimit përbëhet prej shembullit praktik me përgjigje të pyetjeve për punë nga sfera e mbrojtjes së drejtpërdrejtë të trashëgimisë kulturore të patundshme dhe të tundshme.

(5) Pyetjet që janë pjesë përbërëse e shembullit praktik kanë dhjetë përgjigje të mundshme prej të cilave njëra është e saktë, pesë të ngjashme dhe katër të ndryshme.

(6) Nëse kandidati nuk e ka dhënë pjesën e dytë të provimit, do të konsiderohet se provimin nuk e ka dhënë.

(7) Pjesa e tretë e provimit përbëhet nga mbrojtja e temës profesionale të punuar me shkrim, para komisionit nga neni 88-g paragrafi (2) të këtij ligji.

Neni 88-ll

(1) Dhënia e pjesës së parë të provimit bëhet me përgjigjen e numrit të caktuar të pyetjeve në formë të zgjidhjes së testit elektronik në kompjuter.

(2) Pyetjet e testit varësisht nga pesha, vlerësohen me pikë të përcaktuara në test.

(3) Dhënia e pjesës së dytë të provimit kryhet me studim të shembullit praktik dhe përgjigje të numrit të caktuar të pyetjeve që dalin nga shembulli praktik, në formë të zgjidhjes softuerike elektronike (në tekstin e më tutjeshëm: shembull praktik).

(4) Pyetjet nga shembulli praktik varësisht nga pesha, vlerësohen me pikë të përcaktuara në shembullin praktik.

(5) Pyetjet e përmbajtura në testet për dhënien e pjesës së parë të provimit dhe përgjigjet e tyre, pyetjet për shembujt praktikë dhe përgjigjet e tyre, si dhe temat e dorëzuara profesionale të punuara me shkrim, ruhen në sistemin unik elektronik për dhënie të provimit, që e themelon Drejtoria.

(6) Sistemi elektronik nga paragrafi (5) i këtij neni përmban edhe bazë publikisht të arritshme prej së paku 50 pyetje për pjesën e parë të provimit, bazë publikisht të arritshme prej së paku 100 pyetje për pjesën e dytë të provimit, si dhe bazë publikisht të arritshme prej së paku 50 tema profesionale për pjesën e tretë të provimit.

(7) Në sistemin elektronik nga paragrafi (5) i këtij neni, përmbahet udhëzim për literaturën dhe rregullat, prej të cilave rezultojnë përgjigjet e pyetjeve të provimit.

(8) Numri i pyetjeve, shembujve praktikë dhe numri i temave profesionale në bazat nga paragrafi (6) të këtij neni, rritet për 10% në vit, duke filluar nga viti 2015.

(9) Rezultatet nga dhënia e pjesës së parë dhe të dytë të provimit janë të arritshme për kandidatin në kompjuterin në të cilin e ka dhënë provimin, menjëherë pas përfundimit të tij, ndërsa vlerësimi nga neni 88-j paragrafi (5) të këtij ligji i kumtohet kandidatit menjëherë pas mbrojtjes së temës profesionale.

Neni 88-l

(1) Në ditën e dhënies së pjesës së parë, përkatësisht të pjesës së dytë të provimit, përfaqësuesi i Drejtorisë i jep kandidatit kod për qasje, përkatësisht fjalëkalim, me të cilin i lejohet qasje në sistemin elektronik nga neni 88-ll paragrafi (5) i këtij ligji.

(2) Pas lejimit të qasjes, kandidati merr test elektronik për pjesën e parë të provimit, përkatësisht shembull praktik elektronik për pjesën e dytë të provimit, të gjeneruara në mënyrë kompjuterike, përmbajtjen e të cilave sipas zgjedhjes së rastësishme e cakton softueri i sistemit elektronik nga neni 88-ll të këtij ligji.

(3) Pjesa e parë dhe e dytë e provimit, përmbajnë udhëzim për mënyrën e zgjidhjes së tij, për të cilin përfaqësuesi i Drejtorisë jep sqarim, para se të fillojë dhënia e provimit.

(4) Sistemi elektronik për dhënien e provimit nuk mund të lejojë ekzistimin e përmbajtjes identike të testit elektronik për pjesën e parë të provimit, përkatësisht shembullit praktik elektronik për pjesën e dytë të provimit në një termin për më shumë se një kandidat.

Neni 88-m

(1) Në rast të pengimit të realizimit të pjesës së parë ose të dytë të provimit për shkaqe që shpijnë në pamundësi teknike të funksionimit të sistemit elektronik nga neni 88-ll të këtij ligji, dhënia e provimit ndërpritet.

(2) Nëse shkaqet nga paragrafi (1) i këtij neni mënjanohe në afat prej 60 minutash nga ndërprerja e provimit, ai vazhdohet menjëherë pas mënjanimi të tyre.

(3) Nëse shkaqet nga paragrafi (1) i këtij neni nuk mënjanohe në afatin nga paragrafi (2) i këtij neni, provimi ricaktohet për termin tjetër.

Neni 88-n

(1) Kohëzgjatja e përgjithshme e kohës së caktuar për përgjigje të pyetjeve nga pjesa e parë e testit për dhënien e provimit, është 120 minuta.

(2) Konsiderohet se provimin e ka dhënë ai kandidat i cili me përgjigje të sakta të pyetjeve të testit ka arritur së paku 70% nga numri i përgjithshëm i pikëve të parapara pozitive.

(3) Kohëzgjatja e përgjithshme e kohës së caktuar për përgjigje të pyetjeve nga secili prej shembullit praktik të pjesës së dytë, është 120 minuta.

(4) Konsiderohet se provimin e ka dhënë ai kandidat i cili me përgjigje të sakta të pyetjeve nga shembulli praktik, ka arritur së paku 70% nga numri i përgjithshëm i pikëve të parapara pozitive.

(5) Kohëzgjatja e përgjithshme e kohës së caktuar për mbrojtjen e temës profesionale nga pjesa e tretë e provimit, është 120 minuta.

(6) Konsiderohet se pjesën e tretë të provimit e ka dhënë kandidati i cili ka marrë vlerësim “e ka dhënë”.

Licenca për konservator, revizioni i provimeve të realizuara dhe shpenzimet

Neni 88-nj

(1) Drejtori i Drejtorisë, në afat prej 15 ditësh nga dita e përfundimit të provimit të kandidatit i cili e ka dhënë provimin, i lëshon licencë për konservator.

(2) Formën dhe përmbajtjen e licencës për konservator nga paragrafi (1) të këtij neni, e përcakton ministri i Kulturës.

Neni 88-o

Me kërkesa të kandidatit, Drejtoria e informon për gabimet e bëra në testin dhe në shembullin praktik, gjatë dhënies së provimit, me mundësim të shkimt të drejtpërdrejtë në test dhe në shembullin praktik.

Neni 88-p

(1) Testet dhe shmbujt praktikë shfrytëzohen dhe i jepen kandidatit vetëm gjatë dhënies së provimit.

(2) Materialet nga provimet e mbajtura, veçanërisht versionet në letër nga testet dhe shembujt praktikë për dhënien e provimit dhe specimenet për kontroll të saktësisë së përgjigjeve të testit dhe shembullit praktik, temat e dorëzuara profesionale si dhe incizimet nga provimet e mbajtura ruhen në Drejtori.

(3) Drejtoria formon komision për revizion të provimeve të mbajtura, që në punën e vet i shfrytëzon materialet nga paragrafi (2) të këtij neni dhe në të cilin, përveç përfaqësuesit nga Drejtoria, marrin pjesë edhe përfaqësues nga Ministria e Kulturës dhe informatikan nga Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë.

(4) Komisioni nga paragrafi (3) i këtij neni, mban mbledhje së paku një herë në vit dhe kryen revizion të mënyrës së zbatimit të së paku dy provimeve të mbajtura në vitin rrjedhës.

(5) Komisioni nga paragrafi (3) i këtij neni, ka të drejtë të kryejë revizion edhe të mënyrës së realizimit të provimeve të mbajtura në gjashtë muajt e fundit deri në ditën e mbajtjes së mbledhjes së komisionit, por jo më herët nga dita e zbatimit të këtij ligji.

(6) Nëse komisioni nga paragrafi (3) të këtij neni, përcakton parregullsi në realizimin e provimit nga individë sipas nenit 88-x paragrafi (5) të këtij ligji, propozohet heqje e licencës konservatore nga neni 88-nj i këtij ligji.

(7) Drejtori i Drejtorisë miraton aktvendim për heqje të licencës për konservator në bazë të propozimit të komisionit nga paragrafi (3) të këtij neni në afat prej tri ditësh nga pranimi i propozimit.

(8) Kundër aktvendimit nga paragrafi (7) të këtij neni mund të ngrihet kontest administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga pranimi i aktvendimit.

Neni 88-r

(1) Shpenzimet për dhënien e provimit i bartë kandidati.

(2) Shpenzimet nga paragrafi (1) i këtij i përcakton drejtori i Drejtorisë, në bazë të shpenzimeve të bëra reale për dhënien e provimit, të domosdoshme për realizimin e pjesës së parë, të dytë dhe të tretë të provimit, përgatitjen e bazave të pyetjeve, realizimin e testit elektronik, përgatitjen e materialeve dhe thirrjeve dhe përgatitjen e licencave.

(3) Shpenzimet për dhënie të provimit paguhen në llogari të Drejtorisë.

(4) Nëse shpenzimet nuk paguhen në llogarinë përkatëse të Drejtorisë, më së voni 15 ditë para ditës së caktuar për realizimin e provimit, kandidatit nuk i lejohet dhënia e provimit.

(5) Nëse kandidati në afat prej një viti nga dita e pagesës së mjeteve nuk e jep provimin, mjetet e paguara i kthehen në pajtim me ligjin.

Neni 88-s

(1) Licenca e lëshuar për konservator zëvendësohet me të re kur:

- ka ndryshim të të dhënave personale të bartësit të saj,
- për shkak të vjetërsimit ose dëmtimit bëhet e papërdorshme dhe
- është humbur ose në mënyrë tjetër bartësi i saj ka ngelur pa të.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) pikat 1 dhe 2 të këtij neni, licenca për konservator e lëshuar paraprakisht dorëzohet menjëherë në Drejtori, për anulim të saj.

(3) Anulimi i licencës për konservator bëhet nga komisioni treanëtarësh, i caktuar nga radhët e të punësuarve në Drejtori.

(4) Licencën për konservator të humbur, përkatësisht të zhdukur bartësi e paraqet në Drejtori.

Neni 88-t

(1) Licencat për konservator të lëshuara, të hequra dhe të vazhduara, si dhe licencat për konservator që janë shfuqizuar, evidentohen në regjistrin që e mban Drejtoria.

(2) Regjistri nga paragrafi (1) i këtij neni, publikohet në ueb faqen e Drejtorisë.

(3) Formën dhe përmbajtjen e regjistrit dhe mënyrën e mbajtjes së tij, i përcakton ministri i Kulturës.

Neni 88-q

(1) Drejtori i Drejtorisë, me propozim të inspektorit, me aktvendim do ta heq licencën për konservator, nëse bartësi i licencës:

- 1) i realizon punët në kundërshtim me lejen e lëshuar për konservator;
- 2) nuk vepron sipas urdhrave të personit të autorizuar për kryerje të mbikëqyrjes konservatore;
- 3) shkakton dëm ose rrezik për të mirat e mbrojtura;
- 4) i realizon punët në kundërshtim me metodologjinë e përcaktuar të punës dhe
- 5) vepron në kundërshtim me normat etike në sferën e mbrojtjes.

(2) Kundër aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni mund të ngrihet kontest administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga pranimi i aktvendimit."

Neni 3

Në nenin 167 paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

"Inspektor mund të jetë personi i cili:

- është shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- është i moshës madhore,
- ka aftësi të përgjithshme shëndetësore,
- nuk i është shqiptuar dënim me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor për ndalim të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- ka fituar së paku 300 kredi sipas SETK ose shkallë të përfunduar VII/1 – fakultet juridik, ekonomik, arkitektonik, të ndërtimtarisë ose filozofik, që dëshmohet me certifikatë ose diplomë,
- ka pesë vjet përvojë pune në sferën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore,
- i përmbush kushtet tjera të përcaktuara në aktin për sistematizim të vendeve të punës,
- posedon certifikatë të pranuar ndërkombëtarisht për punë me programe kompjuterike për punë në zyrë edhe atë njërën prej këtyre në vijim:

- 1) Certiport: IC3 GS4 Key Applications – të dhënë;
- 2) Microsoft: MOS Word ose MOS Excell – të dhënë ose
- 3) ECDL: Core – të dhënë,

- ka marrë mendim pozitiv për përshtatshmëri për vendin e punës përmes dhënies së testit psikologjik dhe testit për integritet, në pajtim me rregullat që kanë të bëjnë me nëpunësit shtetërorë dhe

- ka licencë për inspektor nga sfera e kompetencës së shërbimit inspektues."

Paragrafët (4) dhe (5) shlyhen.

Paragrafët (6), (7) dhe (8) bëhen paragrafë (4), (5) dhe (6).

Neni 4

Pas nenit 167 shtohet titull i ri dhe nen i ri 167-a, si vijojnë:

"Programi vjetor për punë

Neni 167-a

(1) Drejtori i Drejtorisë përpilon propozim-program vjetor për punë të shërbimit inspektues dhe atë e dorëzon te Këshilli inspektues më së voni deri më 31 tetor në vitin rrjedhës për vitin e ardhshëm.

(2) Drejtori e miraton programin vjetor për punë shërbimit inspektues në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimi të pëlqimit nga Këshilli i inspektues, përkatësisht më së voni deri më 10 dhjetor të vitit rrjedhës nëse Këshilli Inspektues nuk e shqyrton dhe nuk dorëzon pëlqim, respektivisht vërejtje në afatin e përcaktuar me këtë ligj.

(3) Në bazë të programit të miratuar vjetor, drejtori i Drejtorisë përpilon plane tremujore për punën e çdo inspektori, të cilat në mënyrë përmbledhëse i dorëzon për shqyrtim te Këshilli inspektues më së voni dy javë para fillimit të tremujorit të ardhshëm kalendarik edhe atë deri më 15 dhjetor për tremujorin e parë nga viti i ardhshëm, deri më 15 mars për tremujorin e dytë, deri më 15 qershor për tremujorin e tretë, respektivisht deri më 15 shtator për tremujorin e katërt të vitit rrjedhës.

(4) Në planet tremujore për punë për çdo inspektor, drejtori detyrimisht e fut numrin e mbikëqyrjeve të planifikuara për tre muajt e ardhshëm, si dhe shkallën e ndërlikueshmërisë së secilës prej mbikëqyrjeve.

(5) Në bazë të planeve tremujore, për çdo inspektor, drejtori i Drejtorisë përpilon plan mujor për punë, plan i cili përmban edhe orar të mbikëqyrjeve sipas datave dhe sipas subjekteve të mbikëqyrjes.

(6) Drejtori i Drejtorisë, më së voni dy javë nga fillimi i tremujorit kalendarik rrjedhës për atë paraprak, te Këshilli Inspektues dorëzon në mënyrë përmbledhëse raporte tremujore për punën e çdo inspektori, edhe atë deri më 15 janar për tremujorin e katërt të vitit paraprak, deri më 15 prill për tremujorin e parë, deri më 15 korrik për tremujorin e dytë, respektivisht deri më 15 tetor për tremujorin e tretë të vitit rrjedhës.

(7) Drejtori i Drejtorisë më së voni deri më 1 mars të vitit rrjedhës, te Këshilli inspektues dorëzon raport vjetor për punën e shërbimit inspektues, për vitin paraprak."

Neni 5

Neni 171 ndryshohet si vijon:

"Për ankesë të aktvendimit të inspektorit vendos Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë nga Marrëdhënia e Punës në Shkallë të Dytë."

Neni 6

Pas nenit 173-a shtohet nen i ri 173 – b si vijon:

"Neni 173-b

(1) Gjobë në shumë prej 5 000 deri në 6 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit të autorizuar juridik i cili teknikisht e realizon provimin nga neni 88-d të këtij ligji nëse nuk e incizon, nuk e emeton drejtpërdrejt në ueb faqen e Drejtorisë dhe nëse nuk e vendos incizimin e provimit të plotë në ueb faqen e Drejtorisë në pajtim me nenin 88-z paragrafi (3) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 1 000 deri në 1 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet përfaqësuesit nga neni 88-z paragrafi (4) të këtij ligji, nëse vepron në kundërshtim me nenin 88-x paragrafi (8) të këtij ligji.

(3) Gjobë në shumë prej 5 000 deri në 6 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit juridik i cili teknikisht e realizon provimin nga neni 88-d të këtij ligji, nëse nuk e ndërpret provimin në pajtim me nenin 88-x paragrafët (4) dhe (5) të këtij ligji.

(4) Gjobë në shumë prej 1 000 deri në 1 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet drejtorit të Drejtorisë, nëse nuk e miraton aktvendimin në afatin e përcaktuar në nenin 88-p paragrafi (7) të këtij ligji."

Neni 7

Në nenin 174-a pas numrit "173" lidhëza "dhe" zëvendësohet me presje, ndërsa pas numrit: "173-a" shtohet numri: "dhe 173-b".

Neni 8

Aktet nënligjore nga nenet 88-v paragrafi (2), 88-j paragrafi (6), 88-nj paragrafi (2) dhe 88-t paragrafi (3) të këtij ligji do të miratohen në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Neni 9

Personave që kanë marrë licencë për konservator në pajtim me dispozitat nga Ligji për mbrojtje të trashëgimisë kulturore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 20/2004, 115/2007, 18/11, 148/11 dhe 23/13), licenca për konservator u pranohet dhe regjistrohen në regjistrin nga neni 88-t paragrafi (1) i këtij ligji.

Neni 10

Procedurat për dhënie të provimit për marrje të licencës për konservator të filluara deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, do të përfundohen në pajtim me dispozitat e rregullës sipas së cilës kanë filluar.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa nenet 1, 2 dhe 6 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen një vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, ndërsa nenet 3, 4 dhe 5 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen nga 1 maji 2014.